

Dyzet personalitete të famshme, nga A-ja në Z!

Shumë nga artistët, kompozitorët, argëtuesit, zbuluesit, shkencëtarët dhe sportistët kanë lindur në Europë. Në kapitujt e mëparshëm i përmendëm disa prej tyre. Është e pamundur t'i përfshijmë të gjithë ata në këtë libër, kështu që këtu do të përmendim vetëm 40 personalitete, të radhitur sipas rendit alfabetik dhe nga vende të ndryshme të Europës.

Në fund të zgjedhjes suaj personale është një hapësirë e zbrazët. Aty mund të vini ndonjë person të famshëm nga vendi juaj, apo edhe ekipin sportiv apo grupin tuaj pop më të famshëm nga Europa. Pse të mos gjeni ndonjë fotografi dhe ta ngjitni atë në hapësirën e zbrazët, së bashku me disa fakte për ta?



ABBA



© BPA

Grup i muzikës pop: Suedi

Këngët e tyre kanë qenë hite të mëdha në mbarë botën në vitet 1970-ta, dhe kanë mbetur të tilla, duke frymëzuar hitet e famshme muzikore dhe filmike Mamma Mia.

Agatha
Christie



© MWPT/SPL

Shkrimtare: Mbretëri e Bashkuar

Ajo mbahet në mend për romanet e saj me detektivë, të cilët i kanë dhënë asaj titullin 'Mbretëreshë e romaneve të krimit' dhe e kanë bërë atë një nga shkrimtaret më të rëndësishme dhe inovative të këtij zhanri.

Aki
Kaurismäki




© Stéphane ReivFor Picture/Corbis

Drejtor filmi: Finlandë

Regjisor i filmit të famshëm 'Njeriu pa të kaluar' kandidat për çmimin Oskar dhe ka fituar çmim në festivalin e Kanës në vitin 2002.

Albert
Einstein



© Philippe Hakim/Beigru/AFIP

Shkencëtar: Gjermani

Në vitin 1905 ai zbuloi teorinë e relativitetit — me fjalë të tjera, si materia, energjia dhe koha janë të lidhura njëra me tjetrën.

Anne
Frank



© From the Jewish Chron

Shkrimtare: Hollandë

Ajo është njëra nga viktimat më të njohura hebreje të Holokaustit. Ditari i saj është bërë një nga librat më të lexuar në botë.

Antonio
Vivaldi



© Wikimedia

Kompozitor: Itali

Ai ka kompozuar shumë vepra, duke përfshirë Katër Stinët e Vitit (1725).

**Astrid
Lindgren**



© ANK

Shkrimtare: Suedi

Ajo ka shkruar një sërë librash të famshëm për fëmijë, një ndër ta është edhe Pipi Çorapegjata. Librat e saj janë përkthyer në shumë gjuhë dhe janë shitur në më shumë se 145 milion kopje në mbarë botën.

**Carmen
Kass**



© Pierre Vuillemy/Sigma/Corbis

Modele: Estoni

Ajo është paraqitur në kopertinën e revistës Vogue, si dhe ka pozuar në fushata për marka të njohura, siç janë, Chanel dhe Gucci.

Christo



© Lynn Goldsmith/Corbis

Artist: Bullgari

I famshëm për mbështjelljen e ndërtesave, monumenteve e madje edhe pemëve me stofra, siç bëri edhe me Parlamentin e Gjermanisë në vitin 1995.

**Dun Karm
Psaila**



Wikimedia

Poet: Maltë

Ai ka studiuar historinë e Maltës në poezi për të vërtetuar identitetin e saj kulturor dhe kombëtar. Vargjet e tij më vonë u bënë pjesë të himnit kombëtar.

**Franz
Liszt**



Wikimedia

Kompozitor: Hungari

Ai ka shkruar disa nga kompozimet më të vështira për piano, siç është kompozimi Studime Transdentale.

**Fryderiyk
Chopin**



Wikimedia

Kompozitor dhe pianist: Poloni

Ai ka shkruar shumë kompozime për piano, duke përfshirë të famshmin Nocturno.

**Gabrielle
'Coco'
Chanel**



© Man Ray

Stiliste mode: Francë

Veshjet e saj inovative për femra e bëjnë atë figurë të rëndësishme në modën e shekullit të 20-të.

**George
Michael**



© M&A/PPP

Yll ndërkombëtar i muzikës pop: Qipro

Ai arriti famën me hitet e tij, siç është Last Christmas, dhe ka shitur mbi 80 milion albume.

**Georges
Remi
(Hergé)**



© BelgwaAFP

Autor librash komikë: Belgjikë

I famshëm për satirën e tij Aventurat e Tintinit, të cilin e shkroi nga viti 1929 e deri në vdekjen e tij, në vitin 1983.

**Hans
Christian
Andersen**



© ANG

Shkrimtar: Danimarkë

Fabulat e tij të famshme, siç janë Rosaku i Shëmtuar dhe Sirena e Vogël, kanë mrekulluar breza të tërë të fëmijëve në mbarë botën.

**Helena
Rubinstein**



© Interfoto

Afariste: Poloni

Ajo ka themeluar kompaninë e kozmetikës Helena Rubinstein, që e ka bërë atë njëri prej grave më të pasura dhe më të suksesshme të kohës së saj.

Homer



Wikimedia

Poet: Greqi

Poet legjendar i Greqisë antike që thuhet se ka qenë autor i poemave Iliada dhe Odisea.

**Ivana
Kobilca**



Wikimedia

Artiste: Slloveni

Piktorja më rëndësishme e Sllovenisë. Ajo ka pikturuar natyrë të vdekur, portrete dhe peizazhe realiste dhe impresioniste.

**Jean
Monnet**



© EU

Personalitet politik: Francë

Zhvilloi idetë bazë për themelimin e Bashkimit Europian dhe ka ndihmuar në themelimin e Komunitetit të Europës për Qymyrin dhe Çelikun.

**J. K.
Rowling**



© San Young/Sygnma/Corbis

Shkrimtare: Mbretëri e Bashkuar

Autore e vëllimit të famshëm të librave Harry Potter, të cilat janë shitur në më shumë se 400 milion kopje në mbarë botën.

**Joan of Arc
(Zhan D'Ark)**



Wikimedia

Personalitet historik: Francë

Ajo udhëhoqi ushtrinë franceze gjatë Luftës njëqindvjeçare, e cila është zënë rob më vonë, është lidhur në një shtyllë dhe është djegur në moshën 19 vjeçare.

**Krišjānis
Barons**



© Jānis Reikets

Muzikant: Letoni

I njohur si babai i 'dainas' – muzikë dhe poezi tradicionale baltike – portreti i tij është i vetmi që paraqitet në monedhat e Letonisë

**Leonardo
da Vinci**



Wikimedia

Piktor, skulptor, arkitekt, shkencëtar, zbulues dhe filozof: Itali

Ai ka pikturuar portretin e famshëm të Mona Lizës, dhe ka ideuar modelin e parë të helikopterit që në vitin 1493.

Luka
Modrić



Futbollist: Kroaci

Ai ka luajtur me skuadra kryesore të Tottenham Hotspur dhe Real Madrid, si edhe për Kroacinë në kampionate për Kupën e Botës dhe kampionatet europiane.

Marie
Curie
(Maria
Sklodowska)



© Bettmann/Corbis

Shkencëtare: Poloni

Me bashkëshortin e saj Pjer, ajo zbuloi radiumin – metal radioaktiv. Ata fituan çmimin Nobel për fizikë në vitin 1903.

Marlene
Dietrich



© CinemaPhoto/Corbis

Aktore: Gjermani

Ajo ka luajtur në shumë filma, duke përfshirë edhe versionin origjinal të filmit Rreth botës për 80 ditë (1956).

MC Solaar



© Visual Press Agency

Raper: Francë

Ai është njëri prej reperëve francezë më të popullarizuar dhe më me ndikim.

Mikalojus
Konstantinas
Čiurlionis



© BIA/Novosti

Piktor dhe kompozitor: Lituani

Një nga artistët më të famshëm të Lituanisë. Ai ka kompozuar 250 vepra muzikore dhe ka pikturuar mbi 30 piktura.

Nadia
Comăneci



© Wally McNamee/Corbis

Gjymnaste: Rumani

Gjymnastja e parë që ka fituar të gjitha notat dhjetëshe në lojërat olimpike të vitit 1976.

**Pablo
Picasso**



© Ralph Gatti/AFP

Artist: Spanjë
*I famshëm për pikturat e tij
në stilin kubist.*

**Penélope
Cruz**



© NG Collection

Actress: Spanj
*Ajo la luajtur në seriale dhe filma të shumtë botërorë,
dhe ka punuar me regjisorë të famshëm, si Vudi Allen
dhe Pedro Allmodovar.*

**Robert
Schuman**



© BU

Politician: Luxembourg
*Edhe pse ka lindur afër Luksemburgut, ai më vonë u bë
kryeministër i Francës. Ai njihet botërisht si 'babai i Europës'.
Deklarata e Shumanit është bërë më 9 maj 1950, dhe në
shenjë të kësaj date, 9 maji shënohet si Dita e Europës.*

**Štefan
Banič**



© SKC

Zbules: Sllovaki
Ai ka zbuluar parashutën në vitin 1913.

**Steffi
Graf**



© Don Emmert/Bettina/AFP

Teniste: Gjermani
*Ajo është ish-tenistja numër një në botë dhe e vetmja
që ka fituar të katër turnetë Grand Slam në kategorinë
individuale, së paku katër herë secilin turne.*

U2



© Massimo Sestini/Anadolu

Grup i muzikës rok: Irlandë
*Këngët e tyre janë hite mbarëbotërore
që nga vitet 1980.*

Vaclav
Havel



© Massimo Sestini

Autor dramash dhe politikan: Republika Çeke
Ish-autor disident i dramave, i cili kishte kritikuar regjimin komunist dhe ishte kandidat për çmimin Nobel në vitin 2003. Ai ishte kryetari i fundit i Çekosllovakisë dhe i pari i Republikës Çeke.

Vasco
da Gama



© Leemage

Zbulues: Portugali

Një nga zbuluesit më të suksesshëm gjatë Epokës Europiane të zbulimeve. Ai ishte kapiten i anijeve të para që ishin nisur nga Europa për në Indi.

Vivienne
Westwood



© Stephanie Carline/Sygma/Corbis

Disenjatore e modës: Mbretëri e Bashkuar

Ajo solli pankun dhe modën e stilit të ri dhe i bëri ato një rrymë të përgjithshëm gjatë viteve të 1970-ta, dhe vazhdon të jetë aktore e rëndësishme në botën e modës së sotme.

Wolfgang
Amadeus
Mozart



Wikimedia

Kompozitor dhe muzikant: Austri

Si kompozitor i muzikës klasike, Moxarti kompozoi mbi 600 vepra dhe shkroi operën e tij të parë në vitin 1770, kur ishte vetëm 14 vjeç.

Zgjedhja
ime:

